



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e **shtatë** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **31.07.2019** dhe do të filloj në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.
Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për miratimin e projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU);
3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1prill - 30 qershor 2019 (TM2);
4. Raporti i auditimit për vitin 2018 dhe Plani i veprimit;
5. Propozimrregullore mbi themelimin dhe strukturimin e Asamblesë komunale të fëmijëve;
6. Propozimrregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi";
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01-177232/19, më 23.07.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Faqe 1 nga 1